

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush është 25-vjeçari shqiptar që përplasi katër shtete europiane - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/kush-eshte-25-vjecari-shqiptar-qe-perplasi-kater-shtete-europiane/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:16:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 19:15:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6a4dff3c5907f2f6859f809db04d2449d0d63c14cc62e158097cf54029cc9235
TEKSTI	7dc947fc90c437315cbb42dea5a736d6e004db92b69f2228dac713564eaa33c6
PAMJA	aa8f0e69256e57fd4bd2e6a63c45363cf26e3bb0bf96af79e38d2d29b973b361

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	deb26340f1a7c4f3684c5b77cfd651135003a7d3ad4c1f81d681a71ef23d3c02
E MËPARSHMJA	a9230bb554d2642a3dd5d98b809fe9896e3f7ce83e4eddf08b214511f2a604e5
RRËNJJA MERKLE	55f810520a93a3fb0649992dafdc0630325acd6490d1af12697ee3ba7602edf3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/deb26340f1a7c4f3684c5b77cfd651135003a7d3ad4c1f81d681a71ef23d3c02>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Kush është 25-vjeçari shqiptar që përplasi katër shtete europiane

AKTUALITET

Demo

Kush është 25-vjeçari shqiptar që përplasi katër shtete europiane

SEPTEMBER 23, 2026



Historia e Rexhino "Gino" Abazajt, një 25-vjeçar shqiptar i rritur në Itali dhe aktiv në qarqet antifashiste, ka përfshirë në një proces të ndërlikuar ligjor katër shtete europiane: Italinë, Hungarinë, Finlandën, Francën dhe Gjermaninë.

Rexhino Abazaj ka lindur në Shqipëri, por u largua drejt Italisë së bashku me familjen kur ishte vetëm tre vjeç. Ai u rrit atje, ndoqi shkollimin, kreu punën e parë dhe ndërtoi jetën në Itali. Sipas raportimeve, politika është një prej pasioneve të tij dhe ai është aktivizuar në lëvizjet antifashiste.

Megjithatë, ndryshe nga pjesëtarët e tjerë të familjes, Gino nuk arriti të merrte shtetësinë italiane. Sipas historisë së raportuar për të, një prej episodeve që ndikoi në situatën e tij lidhet me një protestë kundër dëbimit nga banesa të një gruaje italiane, e cila nuk kishte mundësi të paguante qiranë.

Pas kësaj ngjarjeje ndaj tij u bë një kallëzim penal, megjithëse çështja më vonë u arkivua dhe ai nuk u dënua për protestën. Pavarësisht kësaj, familja e tij mori shtetësinë italiane, ndërsa Gino mbeti i vetmi pjesëtar pa shtetësi italiane.

Më pas, ai u largua nga Italia dhe shkoi në Finlandë, ku vijoi aktivitetin e tij antifashist. Në vitin 2023, së bashku me aktivistë të tjerë, udhëtoi drejt Budapestit për të ashtuquajturën "Dita e Nderit", një aktivitet ku mbledhen çdo vit grupe të së djathtës ekstreme nga vende të ndryshme të Europës.

Në Budapest pati përplasje mes aktivistëve të ekstremit të majtë dhe atyre të ekstremit të djathtë. Përleshjet shkaktuan disa të plagosur, ndërsa mes personave të akuzuar në këtë çështje ishte edhe Rexhino Abazaj, së bashku me eurodeputeten italiane Ilaria Salis.

Autoritetet hungareze e arrestuan Abazajn, ndërsa ai më pas u lirua në Finlandë. Në Hungari, çështja ndaj tij vazhdoi dhe ai u përball me një dënim të rëndë të dhënë nga drejtësia hungareze.

Ndërkohë, historia e tij mori një tjetër kthesë kur një prej personave të sulmuar gjatë përleshjeve në Budapest rezultoi të ishte shtetas gjerman. Kjo bëri që edhe drejtësia gjermane të kërkonte ekstradimin e Abazajt për t'u përballur me procedurat gjyqësore në Gjermani.

Pasi u largua nga Finlanda, Gino shkoi në Francë, me shpresën se atje do të mund të shmangte ekstradimin. Megjithatë, autoritetet franceze nisën procedurat pas kërkesës së Gjermanisë për dorëzimin e tij.

Më 19 gusht, Franca vendosi në favor të kërkesës për ekstradimin e Rexhino "Gino" Abazajt drejt Gjermanisë. Vendimi u apelua dhe çështja tashmë pritet të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë e Francës.

Më 30 shtator, gjykata franceze pritet të vendosë nëse Abazaj do të ekstradohet në Gjermani. Ndërkohë, ekziston edhe mundësia që pas procedurave në Gjermani, ai të përballlet me një tjetër kërkesë për transferim drejt Hungarisë, ku autoritetet e kërkojnë për vuajtjen e dënimit të dhënë ndaj

+++

Postimet e reja

Kush është 25-vjeçari shqiptar që përplasi kat...

SEPTEMBER 23, 2026

Mbushi Europën me ko*ainë, kush është...

SEPTEMBER 23, 2026

Arrestohet në Rusi një nga personat më të kërkuar...

SEPTEMBER 23, 2026

E ardhmja e Merz nën presion, 45% e...

SEPTEMBER 23, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 22, 2026

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Situata financiare e një prej ish-gjigantëve të grumbullimit dhe eksportit të fruta perimeve, "Top Fruits",...

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznes të paktën 1-vjeçare**Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!****Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbapsht**

Na ndiq

25

Rasti i 25-vjeçarit shqiptar ka tërhequr vëmendjen e mediave në Itali, Francë, Hungari dhe Gjermani, ndërsa për 30 shtatorin në Paris janë paralajmëruar protesta nga grupe të majta në mbështetje të Abazajt. Protestuesit pritet t'i kërkojnë Gjykatës së Lartë franceze të mos e ekstradojë shqiptarin drejt Gjermanisë.

Kështu, një çështje që nisi me jetën e një shqiptari të rritur në Itali dhe aktivitetin e tij politik është shndërruar në një proces ndërkufitar, ku përfshihen drejtësitë e disa vendeve europiane dhe ku vendimi i radhës pritet të merret në Paris më 30 shtator.

25-vjeçari

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët,
mundësi fitimi dhe sfida në punë,
çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3
shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.